



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-100

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN NË
PRONËN E PALUAJTSHME Nr. 03/L-204**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN
NË PRONËN E PALUAJTSHME Nr. 03/L-204**

Neni 1

Pas nenit 1 të ligjit bazik shtohet neni i ri 1.A me tekstin si vijon:

1.A
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi i normës për pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme dhe procedurës së ankimit.

Neni 2

Neni 7 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 7 Shkalla e tatimit

1. Kuvendi komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën tatimore prej zero pikë pesëmbëdhjetë përqind (0.15 %) deri një përqind (1 %) të vlerës së pronës në treg.
2. Pronë e papërfunduar është prona në ndërtim e sipër, që nuk i plotëson kushtet për shfrytëzim normal dhe që do të vlerësohet dyzet përqind (40%) e vlerës së pronave rezidenciale dhe me normë të tatimit të po këtyre pronave.

Neni 3

Neni 15 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 15 Pagimi i Tatimit

1. Për çdo vit fiskal, tatimi komunal mbi pronën e paluajtshme paguhet në dy (2) këste të barabarta me ose para 30 qershor dhe 31 dhjetor të vitit tatimor.
2. Pagesa e tatimit në pronë duhet të bëhet në tërësi nëse kërkohet të bëhet transfer i pronës apo ndërrim i pronarit qoftë ai tatimpagues i ligjshëm, shfrytëzues i ligjshëm apo shfrytëzues tjetër sipas nenit 5 të ligjit bazik.
3. Pagesa e tatimit për pronat e ish ndërmarrjeve shoqërore që janë privatizuar duhet të bëhet sipas llogaritjeve në përputhshmëri me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu edhe llogaritjen e dënimit dhe kamatës sipas neneve 20 dhe 21 të ligjit bazik.

Neni 4

Neni 22 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi Komunal, mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit nga Bordi Komunal:
 - 1.1. deri më 30 nëntor 2012 në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave.

1.2. nga 1 dhjetori 2012 në Divizionin Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në pajtim me nenin 81.B të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

2. Nëse Bordi Komunal nuk ka marr vendimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën ankesa ishte dorëzuar, tatimpaguesi mund të ushtrojë ankesë në mënyrë drejtpërdrejtë në organet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, sipas kompetencës së tyre.

3. Tatimpaguesi i cili, nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, mund të ankohet në Gjykatën Supreme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të pranimit të vendimit, deri më 30 nëntor 2012.

4. Nga 1 dhjetori 2012, gjykatë kompetente për të pranuar ankesa kundër vendimit të lëshuar nga organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, është Gjykata Themelore në Prishtinë.

5. Në procedurën e ankesës, për çështjet që nuk janë paraparë me këtë ligj, gjen zbatim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222.

Neni 5 **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-100
20 prill 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI